



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Inspektorateve  
Inspektorati komunal  
Nr. 17-355-zyrtarisht  
Dt. 02.04.2026

Inspektorati komunal duke vepruar sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 168 të Rregullores për Shërbime Publike Komunale në Komunën e Prizrenit, me nr. 001/011-73507 të datës 04.06.2024 nxjerr këtë:

## NJOFTIM

Njoftohen te gjithë pronaret e lokaleve të cilët ekspozojnë mallra (pemë e perime, tekstil, plastikë, etj) para lokaleve afariste e që nuk janë të pajisur me leje nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor se nga data **16.04.2026** inspektorati komunal do të ndërmarrë aksion për largimin e tyre me qëllim të lirimit të të gjitha hapësirave publike dhe krijimit të qasjes së lirë të qytetarëve në këto hapësira.

Paraprakisht të gjithë pronarët që ekspozojnë mallra në hapësira publike janë njoftuar me shkrim dhe me gojë.

**Të gjithë pronarët e lokaleve që nuk veprojnë sipas këtij njoftimi do të gjobiten me gjoba mandatore si dhe mallrat që nuk janë larguar pas këtij njoftimi do të konfiskohen ndërsa të gjitha shpenzimet rreth konfiskimit do t'i bartin pronarët e bizneseve.**



Drejtoresha e Inspektorateve

Samra Iliazi-Latic